

EDMOND MALAJ

**DISA ASPEKTE NGA EKONOMIA
E SHKODRËS MESJETARE**

Shkodra ishte një ndër qytetet më të mëdha dhe më të rëndësishme të hapësirës arbërore në Mesjetë dhe të flasësh për ekonominë e këtij qyteti gjatë kësaj periudhe në mënyrë të detajuar në një artikull të vetëm është diçka e përealizueshme, sepse kjo temë kërkon një monografi studimore. Megjithatë hapësira që na jep artikulli na lejon të përmendim disa aspekte kryesore të ekonomisë së këtij qyteti.

Këtu do të përpiqemi të japim një panoramë të ekonomisë së Shkodrës në Mesjetë, duke u përqendruar kryesisht në gjysmën e parë të shek. XV, për të cilën kemi edhe të dhëna dhe burime dokumentare më të shumta. Artikulli në fjalë ka si qëllim që të cekë çështjet më kryesore ekonomike.

Në shek. XV kemi një përshkrim shumë interesant të Marin Barletit mbi begatinë e Shkodrës. Barleti shkruan se, *“Ky qytet aq i shkëlqyeshëm e aq i njoftun dallohet mbi të tjerë për ajër të shëndetshëm, për ara pjellore e të punueme mirë dhe për ujna që i ka me shumicë. Nga qyteza syni i përland thuajse të gjitha fushat për rreth, asgja s’e pengon të pamit; prej andej i sheh të gjitha tokat që përfshijnë një hapërsinë të madhe, edhe çdo gja dallohet imtësisht. Prej andej sheh bujq që lëvrojnë tokën, korrcarë që korrin të lashtat, sheh mullinj, peshkatarë sa ndër lumenj, sa ndër liqe, (e çfarë liqeni!) tue gjuejtë peshk që del me shumicë të madhe. Mbasandaj ke vëneshtat, kopështijet, burimet, liqenin e çdo gja që ka krijë natyra për të kënaqë njerinë.”*¹ Një tablo shumë e bukur kjo, që mund të dalë vetëm nga pena e një shkrimtari të madh siç ishte Barleti. Edhe senatori venedikas Malinpiero na jep një panoramë shumë të bukur në lidhje me begatinë e Shkodrës po në të njëjtën periudhë, si Barleti.

Në përshkrimin e Malinpieros lexojmë si më poshtë: *“qytet i Shqipërisë, i vendosur mbi një mal shumë të lartë, dhe që ka përreth një krahinë pjellore dhe të bollshme me të gjitha gjërat e nevojshme. Ky qytet në pjesën e tij përfundimor ka një liqen që lag një sipërfaqe prej 80*

¹ Marin Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*, përktheu nga origjinali latinisht Henrik Lacaj, botim i dytë i shtuar, Universiteti i Tiranës, Tiranë: 1967, f. 37.

miljesh, nga ujërat e të cilit lind lumi Bojana që rrjedh rrëzë malit. Në anën lindore ka një lum tjetër që e quajnë Drin. Gjithë ky lum është shumë i madh, kështu që mbi të mund të lundrojnë anijet për shumë milje (këtu bëhet fjalë sërish për Bunën – E. M.): ka fusha nga njëra anë në tjetrën, të cilat pa shumë mund nga punëtorët, sapo të hidhet fara e grurit në tokë, jep prodhim të mrekullueshëm: fusha është mjaft e pasur me bar, kështu që delet (bagëtitë) nuk vuajnë nga uria (?). kjo krahinë është e rrethuar nga male shumë të ashpra dhe shumë të larta; kodrat janë plot me vreshta e me ullinj; pranë kënetave afër bregdetit ka pyje shumë të mëdha, në të cilat ka lëndë druri të një sasive të madhe, të gjithfarë llojit”².

Më poshtë do të shqyrtojmë burimet ekonomike të Shkodrës të paraqitura në këto përshkrime, duke u munduar të japim një pasqyrë relativisht të gjerë të aspekteve kryesore të ekonomisë së Shkodrës gjatë Mesjetës. Burimet kryesore, në të cilat do të bazohemi janë *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*³, i cili na shërben si burimi kryesor për një njohuri më të mirë të zonës përreth. Kadastra u shkrua në vitin 1416 nga noteri venecian Petrus de Sanctodorigo de Parma⁴. Kjo vepër është një kodeks i madh që përbëhet prej 172 fletësh dhe gjendet në Bibliotekën e Shën Markut në Venecie.⁵

² “città d’Albania, situada su un monte altissimo, che ha d’attorno una region fertile, abundante de tutte le cose neppesarie. Questa città ha dalla parte de occidente un lago che circonda 80 mia, da’l qual nasce’l fiume Bogiana, che discorre alle raise de’ l monte della terra: dalla banda de Oriente ha un altro fiume che se chiama el Drin; tutti do questi fiumi è molto grossi, in modo che le nave grosse può navegar per essi molte mia: ha pianura da una banda e dall’ altra , che senza fadiga de i lavoradori, butade le semenze del gran in terra, rende frutto mirabele: la campagna è tanto grassa t che prohibisse alle piegore el starghe longamente azzochè le no patissa de repletion. Questa region è circondata da monti asprissimi e altissimi; i colli è pieni de vigne e de olive; apresso alla palude verso marina ha boschi grandissimi, ne i quali che è gran quantità de legnami da ogni fattion. D. Malinpiero, *Anali Veneti* , f. 92.”, në Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike 1392-1479*, shqip nga Ardian Klosi, Tiranë: Fjala, 2014, f. 25.

³ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1977.

⁴ *Po aty*, f. 1/a.

⁵ Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin K. Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla

Kadastra përmend emrat e banorëve nëpër lokalitetet e veçanta dhe jep masën e pagesës së taksave të tyre. Në vitin 1421, qeveria e Venedikut urdhëroi që, për Shkodrën, Drishtin dhe Ulqinin të bëhej një regjistër i ri kadastror (*catasticum novum*), por nga kjo kadastër e dytë, deri më sot nuk është gjetur asgjë.⁶

Burimi tjetër kryesor, tek i cili do të bazohemi për këtë artikull janë edhe “*Statutet e Shkodrës*”⁷. Statutet, ky monument i rëndësishëm i historisë së Shqipërisë mesjetare, na japin një vështrim të detajuar të organizimit të qytetit duke përfshirë këtu edhe organizimin ekonomik të tij. Ato u krijuan para vitit 1346, kur Shkodra ishte nën pushtetin e Mbretit serb Stefan Dushan dhe mbetën në fuqi edhe më vonë, kur qyteti kaloi nën sundimin venedikas, deri me pushtimin osman të qytetit më 1479.

Të një rëndësie jashtëzakonisht të madhe janë dokumentet, të cilat zënë në këtë artikull një vend të veçantë. Të dhënat dokumentare janë nxjerrë kryesisht nga vëllimet dokumentare të at Zef Valentinit SJ me titull “*Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*” (*Akte të Shqipërisë Venedike të shekujve XIV dhe XV*) botuar në vitet 1967-1972;⁸ më tej nga “*Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*” (*Akte dhe Diploma që ilustrojnë çështje të Shqipërisë së kohës së mesme (Mesjetës)*)⁹ të autorëve Konstantin Jireček (Konstantin Jireček), Ludvig fon Tallosci (Ludwig von Thallóczy) dhe Milan fon Shufflay (Milan von Sufflay). Më tej me rëndësi janë edhe tre vëllimet e përfshira në kolanën

Péché und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 110.

⁶ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...”, f. 110.

⁷ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469 / Statuti di Skutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*, përgatitur nga Lucia Nadin, përkthimi i tekstit të Statuteve Pëllumb Xhufi, redaktor Ferdinand Leka, Tiranë: Onufri, 2010.

⁸ *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV* (më tej: AAV), Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata, Tomi (Vol.) 1-25. Palermo/ Napoli/ Roma/ Venezia/ München: Archivio di Stato di Venezia, 1967-1972.

⁹ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia* (më tej: AAlb), Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen; *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen II (Annos 1344-1406 continens) (Nr. 555 et passim) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen.

*Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV: Vëllimi I (1400-1405)*¹⁰; Vëllimi II (1406-1410)¹¹; Vëllimi III (1411-1415)¹² të përkthyer dhe të përgatitura nga Injac Zamputi në bashkëpunim me Luan Malltezin, Pranvera Bogdanin edhe Përparime Hutën.

Përveç vëllimeve dokumentare u përdorën punime të ndryshme të autorëve si Milan von Shuflaj, Konstantin Jireçek, Oliver Jens Schmitt etj. Kjo është literatura që përbën kuadrin e këtij artikulli mbi disa aspekte ekonomike të Shkodrës mesjetare, temë të cilën shpresojmë ta zgjerojmë në të ardhmen.

Llojet e parave

E kemi nisur me paranë pasi, qoftë nëpër dokumente, qoftë nëpër statute, qoftë në Kadastër, jepen gjithë shumat e parave që paguheshin dhe taksoheshin. Pra, gjithçka sillej, edhe në atë kohë, rreth parasë. Në Shkodër përdoreshin monedha të shumta që ishin shtypur në jashtë qytetit. Megjithatë qyteti kishte edhe monedhat e veta, të cilat duhet të ishin shtypur në afërsi të qytetit të Shkodrës siç mund të ishte qyteti i Kotorrit, i cili në mesjetë kishte edhe një zekë.¹³ Monedhat që përdoreshin në Shkodër e rrethina ishin të llojit *folar bakri*, groshë (*Grosso*), perper apo hyperperi (*perpero*), perper i Skllavonisë (*perpero di Sclavonia*), dhe solda (*suldin*) etj.

Paraja më e madhe në qarkullim duket se ishte *dukati*. Vlera e tij fillestare ishte 40 solda të mëdha ose 60 solda të vogla. Kur trojet u pushtuan nga Perandoria Osmane në fillim të shek. XVI, një dukat vlente

¹⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. I (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1987.

¹¹ Gjendet në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*) të Akademisë së Studimeve Albanologjike, A-III-563. Vëllimi është transkriptuar dhe përkthyer nga Injac Zamputi në bashkëpunim me Pranvera Bogdanin. Botimi është duke u përgatitur për shtyp nga Edmond Malaj, autor i këtij artikulli.

¹² *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. III (1411-1415), transkriptuan dhe përkthyen Injac Zamputi dhe Përparime Huta, redaktori dhe përgatiti për botim Edmond Malaj, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike 2018.

¹³ Temën rreth llojeve të parave e kemi cekur edhe më parë në monografinë: Edmond Malaj, *Drishti. Historia edhe fizionimia e një qyteti mesjetar shqiptar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2016, f. 226.

rreth 40 akçe.¹⁴ Si para e dytë më e madhe ishte hyperperi, i cili ishte 1/3 e dukatit,¹⁵ por edhe kjo monedhë në gjysmën e parë të shek. XV shfaqet në disa lloje me vlera të ndryshme të cilat ishin: hyperperi në Arbëri (*hyperperum in Albania*)¹⁶ dhe hyperperi i Kotorrit (*hyperperum Catarensium*)¹⁷.

Groshi ishte dy madhësish, i madh dhe i vogël. Ai ishte 1/24 pjesë e dukatit.¹⁸ Me përkeqësimin e cilësisë së monedhave groshët bëhen me vlerë gjithnjë e më të vogël për shkak të papastërtisë së metaleve dhe të masave. Përveç kësaj shfaqen tipe të ndryshme groshësh që njiheshin si groshi i Raguzës (*grossi Ragusii*)¹⁹, groshi katorras (*grossi Catarensis*)²⁰, groshi i Arbërisë (*grossi Albaniae*)²¹, groshi i Balshës (*grossi Balsae*)²², dhe groshi i monedhës së keqe (*grossi malae monete*)²³.

Si rrjedhim për të treguar vlerën e këmbimit të këtyre monedhave sidomos gjatë gjysmës së parë të shek. XV po japim një tabelë pasqyruese²⁴:

1 dukat (<i>ducatus</i>)	= 0, 1 libra groshësh (<i>librae grossorum</i>)
"	= 3, 070 hyperperë në Arbëri
"	= 4 libra të voglash (<i>librae parvorum</i>)
"	= 5-6 hyperperë Kotorri (<i>hyperpera Catarensia</i>)
"	= 6 groshë Raguze (<i>grossi Ragusii</i>)
"	= 30 groshë Kotorri (<i>grossi Catarensis</i>)
"	= 40 groshë Arbërie (<i>grossi Albaniae</i>)
"	= 56 groshë të Balshës (<i>grossi Balsae</i>)
"	= 90 groshë të monedhës së keqe (<i>grossi malae monetae</i>)

Para të tjera që përdorehin sidomos gjatë kohës së Venedikut kanë qenë *hekzagia* dhe *unza*. Hekzagia (lat. *exagium*) ishte prej floriri dhe ishte një e gjashta e një unze.²⁵ Unza në fakt ka qenë njësi peshe e lashtë

¹⁴ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, f. 222.

¹⁵ *Po aty*, f. 223.

¹⁶ AAV XVI, f. 217

¹⁷ AAV XVI, nr. 3941, 3942.

¹⁸ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, f. 222.

¹⁹ AAV XVI, nr. 3941, 3942.

²⁰ AAV XVI, f. 217.

²¹ AAV XVI, nr. 3941, 3942.

²² AAV XVI, nr. 3942.

²³ *Po aty*.


²⁴ Tabela është marrë nga: AAV XVI, f. 217; shih edhe AVV XVI, nr. 3941, 3942.

²⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV...*, vëll. I (1400-1405), f. 651.

dhe masë gjatësie, më vonë edhe për monedhat dhe peshonte 29 gram.²⁶ Një monedhë tjetër që përdorej në atë kohë ishte edhe solda, ajo ndahej në solda të mëdha dhe në solda të vogla, të cilat përbëheshin nga 12 dinarë të mëdhenj (soldat e mëdha) ose 12 dinarë të vegjël (soldat e vogla).²⁷ Kaq mund të thuhet deri më tani për specifikat e monedhave.

Disa monedha të Shkodrës po i shohim më konkretisht nga shembujt e mëposhtëm. Informacionet e para rreth monedhave nga Shkodra i kemi nga Karl Shtokert (Stockert), në revistën austriake “*Numismatische Zeitschrift*”²⁸ në vitin 1909, i cili na jep skicat dhe përshkrimet e disave prej tyre. Pastaj pamje konkrete na ofron “*Numismatik Lanz München*” e cila na paraqet disa monedha nga Shkodra me pamjet e tyre origjinale dhe me të dhëna specifike mbi to. Në lidhje me përdorimin e monedhave ndonjë të dhënë mund të gjejmë edhe tek statutet e Shkodrës, në të cilat këto monedha përmenden vazhdimisht.

*Lista e mëposhtme me monedha dhe të dhënat e tyre janë marrë nga Numismatik Lanz*²⁹

Nr	Pamja	Përshkrimi
1		Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404-1474. Dimens. = 20 mm. Tipi: <i>Grosso</i> , e shtypur gjatë viteve 1408-1410 në Kotorr në kohën e administrimit të <i>Benedetto Contarinit</i> . Në monedhë paraqitet <i>Shën Shtjefni</i> patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezak të vijëzuar nga pika (perla). Në anën e pasme paraqitet <i>Luani i Shën Markut</i> , simbol i Venedikut. Pesha: 1.06 g.

²⁶ *Po aty*, f. 657.

²⁷ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve...*, f. 224.

²⁸ Karl Stockert, “Über einige noch unedierte Münzen Aus Scutari und und Drivasto”, në *Numismatische Zeitschrift*. Hrsg.von den numismatischen Gesellschaft in Wien. Neue Folge, Band II. Der ganzen Reihe XLII (1909), f. 221-228.

²⁹ Monedhat e paraqitura dhe të dhënat e tyre marrë nga: Städte in Dalmatien. Sammlung C: Scutari (Skadar). URL: <http://www.lanzauctions.com/search.php?a=skacUO6DJnspnxl8rWQXdbkTwl0pfAuCGMCRyz3Tu0%3D> (9. 12. 2018)




Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Gjergj II Strazimir Balshës 1385-1405. Dimens. = 21 mm. Tipi *Grosso* pa vit të shtypjes. Aty paraqitet: S STEFAN - SCVTAREN, (*Shën Shtjefni* i Shkodrës në këmbë). Në anën e pasme shkruhet: M DE GORGI -.D.SRACIMIR., (M e Gjergj Strazimirit) me stemën e Balshajve me përkrenare. Pesha 1,36 g.



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404-1474. Dimens. = 21 mm. Tipi: *Grosso*, e shtypur gjatë viteve 1439 - 1440 në Kotorr nën qeverisjen e *Paolo Morosinit*. Aty paraqitet .S.STEFANVS :SCVTARENSIS, (*Shën Shtjefni* i Shkodrës në këmbë midis germave P - M.) Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*, simbol i Republikës së Venedikut. Pesha 1,05g.



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404-1474. Dimens. = 21 mm. Tipi: *Grosso*, e shtypur gjatë viteve 1451-1453 nën qeverisjen e *Nicolo Diedo-s*. Në monedhë paraqitet *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezak të vijëzuar nga pika (perla), midis germave N dhe D. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*, simbol i Republikës së Venedikut. Pesha 1,06g.



Monedhë e Shkodrës (Scutari). Shtypje autonome Dimens. = 19 mm. Tipi: *Follaro* pa vit dhe nuk dihet vendi i prerjes. Në njërën anë paraqitet stema e qytetit, kurse në anën e pasme është

Shën Shtjefni në këmbë, duke mbajtur në krahë Jezusin fëmijë. Pesha 1,34g.³⁰



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404-1474. Dimens. = 20 mm. Tipi: *Grosso*, e prerë gjatë viteve 1442-1444 në Kotorr nën qeverisjen e Francesco Querinit. Në monedhë paraqitet SCVTARENSIS, S. STFANUS. *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezak të vijëzuar nga pika (perla) midis germave F - Q. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*, simbol i Republikës së Venedikut. Pesha: 1,02g.



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404-1474. Dimens. = 21 mm: Tip *Grosso*, i prerë gjatë viteve 1435-1437 në Kotorr nën qeverisjen e Zuanne Boldu-s. Në monedhë paraqitet *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezake të vijëzuar nga pika (perla) midis germave Z-B. Në anën e pasme paraqitet VENETIA.RVM dhe *Luani i Shën Markut*, simbol i Republikës së Venedikut. Pesha: 1,08g.



Monedhë e Shkodrës (Scutari). Shtypje autonome Dimens. = 20 mm. Tipi *Follaro* nuk dihet as vendi e as viti i prerjes. Në njërën anë paraqiten gerrat S.STEF - ANVS, (*Shën Shtjefni* ndenjtur). Në anën e pasme paraqitet STEF-ANVS, *Shën Shtjefni* në këmbë që mban enën e kemit (temjanit) si diakon. Pesha: 1,6 g.³¹

³⁰ Shih edhe: K. Stockert, "Über einige noch unedierte Münzen aus Scutari ...", f. 224.

³¹ Shih edhe: po aty, f. 223.

9



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404 – 1474. Dimens. = 21 mm. Tip *Grosso*, i prerë gjatë viteve 1439 - 1440 në Kotorr nën qeverisjen e Paolo Morosinit. Në monedhë paraqitet *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës midis germave P - M. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*. Pesha 0,97g.

10



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404 – 1474. Dimens. = 21 mm. Tip *Grosso*, i shtypur gjatë viteve 1439 - 1440 në Kotorr nën qeverisjen e Paolo Morosinit. Në monedhë paraqitet *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezake të vijëzuar nga pika (perla) midis germave P - M. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*, dy pika si shenjë pikësimi. Pesha 1,04g.

11



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404 – 1474. Dimens. = 21 mm. Tip *Grosso*, i shtypur gjatë viteve 1437-1439 në Kotorr nën qeverisjen e Bertruci Civran-it. Në monedhë paraqitet *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezake të vijëzuar nga pika (perla) midis germave B - C. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*. Pesha 1,06 g.

12



Monedhë e Shkodrës (Scutari), e shtypur në periudhën e Venedikut 1404-1474. Dimens. = 21 mm. Tip *Grosso*, i shtypur gjatë viteve 1437-1439 në Kotorr nën qeverisjen e Bertruci

Civran-it. Në monedhë paraqitet *Shën Shtjefni* patron i Shkodrës brenda një rrethi në formë vezake të vijëzuar nga pika (perla) midis germave B - C. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*. Pesha 1,07 g.

13



Monedhë e Shkodrës, e shtypur në periudhën e Venedikut 1404 – 1474. Dimens. = 21 mm. Tip *Grosso*, i shtypur gjatë viteve 1442 - 1444 në Kotorr nën qeverisjen e Francesco Querini-t. Në monedhë paraqitet SCVTARENSI, (*Shën Shtjefni*) patron i Shkodrës brenda në rreth në formë vezake të vijëzuar nga pika (perla) midis germave F-Q. Në anën e pasme paraqitet *Luani i Shën Markut*. Pesha 1 g.

14



Monedhë e Shkodrës. Shtypje autonome Dimens. = 21 mm. Tipi *Follaro* nuk dihet as viti as vendi i shtypjes., Në monedhë paraqitet S.STEF - ANVS (*Shën Shtjefni* në këmbë). Në anën e pasme shkruhet SCVTAR-ENSIS (e Shkodrës) dhe paraqitet *Shën Shtjefni*, në të djathtë të tij ka yje. Pesha 2,41 g.³²

Këto pra ishin disa të dhëna rreth monedhave që përdorshin në Shkodër me disa pamje përkatëse të tyre. I dhamë të gjitha këto monedha ashtu siç i gjetëm në "*Numismatik Lanz*"³³, ngaqë secila është unikalë, e shtypur në periudha të ndryshme, të panjohura në shumicën e tyre dhe që kanë rëndësinë e vet për historinë ekonomike të Shkodrës.

³² Shih: po aty.

³³ Monedhat e paraqitura dhe të dhënat e tyre marrë nga: Städte in Dalmatien. Sammlung C: Scutari (Skadar). URL: <http://www.lanzauctions.com/search.php?a=skacUO6DJnspnxl8rWQXdbkTwl0pfAuCGMCRyz3Tu0%3D> (9. 12. 2018)

Tregtia

Tregtia kishte një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për Shkodrën dhe rrethinat e saj. Në lidhje me lundrimin dhe tregtinë me anë të tij, Shkodra posedonte qoftë një port në liqen, qoftë një port lumor në Shën Shirq të bregut të Bunës, nga ku mund të dilje në det. Pranë manastirit të Shirqit gjendej një shesh që kryente funksionin e një porti për anijet tregtare, një zyrë doganore dhe një magazinë kripe. Aty shkarkoheshin dhe grumbulloheshin sasi të kripës para se ato të niseshin për në Shkodër.³⁴ Prandaj flitet kaq shumë për “*Sanctus Sergius*” ose për “*portus Sancti Sergii de Drino (Oldrino)*”, serbisht “*Sveti Srgj*” në dokumentet mesjetare sidomos të atyre të Raguzës.³⁵ Për vitin 1377 përmendet edhe një “treg vjetor” (*panagjur*) në Shën Shirq. Mallrat që importoheshin aty ishin pëlhura, verë nga Dalmacia e Italia dhe kripë deti etj., kurse mallrat që eksportoheshin prej aty ishin lëndë druri, dyllë, kallaj dhe argjend nga Serbia, peshk nga Shkodra etj.³⁶

Një rrugë tjetër e gjallë tregtie për Shkodrën ishte edhe ajo (*via Sclavonesca*) që të çonte për në Prizren dhe Novo Bërdë³⁷ e më tej për në Serbi, pra që lidhte qytetin me botën sllave. Në Shkodër silleshin mallra si dyllë, kripë deti dhe argjend, brenda prodhoheshin pëlhura dhe nga liqeni i Shkodrës vinte peshku i kripur.³⁸ Përsa i përket kripës, Shkodra kishte të ashtuquajturën “Dhomë të Kripës”, e cila pas pushtimit të qytetit nga osmanët vendoset në Ulqin.³⁹ Rruga nga hynte kripa zakonisht ishte nëpërmjet portit të Shën Shirqit, ku siç e përmendëm edhe më sipër ishin edhe dogana dhe një magazinë për kripën.⁴⁰

Aty vinin anije të ngarkuara me këtë produkt, e shkarkonin dhe ngarkoheshin me mallra të tjera si p. sh. me plumb, si në rastin e

³⁴ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV ...*, vëll. I (1400-1405), nr. 166.

³⁵ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...”, f. 117.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty, f. 109.

³⁸ Po aty.

³⁹ *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)*, Pjesa e dytë (1499-1506), përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1979, dok. nr. 17 (22), f. 34-35.

⁴⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV...*, vëll. I (1400-1405), nr. 166.

dokumentit të cituar më poshtë.⁴¹ Si rrugë tjetër e kripës nuk përjashtohet edhe rruga e vjetër lidhëse ndërmjet Shkodrës dhe Tivarit që kalon nëpër krahinën e Shestanit e të Krajës dhe mbërrinte në treg poshtë kalasë.

Kripa e bashkisë shitej nga njerëz të veçantë, të besuar të cilët e bënë këtë punë me kërkesën e zotërinjve të *llogarive të vjetra*. Llogaritë e vjetra nënkuptonin një zyrë për shpenzime publike, për kontrollin dhe kërkesën e llogarisë ndaj atyre personave që përdornin të hollat e shtetit.⁴² Kripa ishte një artikull me të cilin bëhej kontrabandë dhe për këtë në periudhën e sundimit venedikas merreshin masa vazhdimisht kundër këtij fenomeni. Si shembull, mund të përmendim, këtu, një rast në vitin 1408 ku senati venedikas vendos një bregantin të armatosur mirë kundër kontrabantës që bëhej në zonat e Shkodrës dhe në Gjirin e Drinit, me kripë që vinte nga Vlora dhe me drithë nga Ragusa.⁴³ Brigantinin në fjalë për shërbimin e tij duhej ta paguante kontkapiteni i Shkodrës.

Gjatë periudhës 1416-1417 kripën e bashkisë së Shkodrës e shiste Gajard Gajadi, i cili e mbantë atë në një shtëpi prej dërrase të mbuluar me dërrasa e me kashtë, pranë murit të qytetit dhe afër kishës së Shën Mërisë së Shkodrës.⁴⁴

Qyteti i Shkodrës në Mesjetë kishte edhe sheshin e vet të tregut, i cili ndodhej diku në rranzat e kështjellës,⁴⁵ sipas Barletit, “jashtë ledheve sa hjedh peshën”⁴⁶.

Mbase Pazari i Vjetër i Shkodrës, i cili u ndërtua gjatë periudhës osmane dhe u shkatërrua gjatë sistemit komunist, i ngritur pikërisht mbi gjurmët e tregut të vjetër mesjetar. Për fat të keq këtë nuk do të jemi në gjendje ta mësojmë, pasi aty janë bërë ndryshime të mëdha dhe nga objektet e vjetra nuk ka mbetur më asgjë. Në Shkodër kishte edhe një komitet tregtarësh raguzan, të cilët kishin krijuar një lagje të tyren në afërsi të kishës së Shën Vlashit, poshtë kalasë dhe në afërsi të portit, në

⁴¹ Më 22 shtator 1407 në Raguzë bëhet marrëveshje për të ngarkuar dy anije me kripë në Durrës dhe për t'i shkarkuar në Shirq, ku do të ngarkohen me plumb të caktuar për Venedik. *AIH, A-III-563, Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV...*, vëll. II (1406-1410), dok. nr. 166.

⁴² *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, f. 205.

⁴³ *AIH, A-III-563, Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV...*, vëll. II (1406-1410), dok. nr. 234.

⁴⁴ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, f. 3/a.

⁴⁵ M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës...*, f. 46.

⁴⁶ *Po aty*, f. 69.

zonën e ashtuquajtur “Nënshkodër” (*Sub-Scutari*).⁴⁷ Ardhja e tregtarëve raguzanë dhe krijimi i një kolonie të tillë, tregon për rëndësinë që ka pasur Shkodra në tregti brenda pellgut Adriatik.

Peshkimi

Në lidhje me ujërat në Shkodër mund të themi që gjatë Mesjetës ishte liqeni, lumi Buna, një degë e vogël e Drinit e quajtur Drinassa, pasi dega kryesore kalonte nga Lezha në verilindje vinte Kiri, i cili lidhej me Drinin. Peshkimi ishte një degë shumë e rëndësishme e ekonomisë së qytetit të Shkodrës, e cila pati marrë nga car Dushani një krisobulë privilegji në lidhje me këtë aktivitet.⁴⁸ Në liqenin e Shkodrës ziheshin këto lloj peshqish: nila, krapë, ngjala, saraga (gjuhca), kubla, qefulli, levreku (në Bunë), blini, ballgjieri, mlyshi, peshku lesh etj. Për këtë peshk të pasur që zihet gjatë dymbëdhjetë muajve të vitit na jep të dhëna si më poshtë edhe Françesko Bolica⁴⁹:

- Në janar saraga (gjuhcat e thata);
- në shkurt gjuhcat (*scoranze*) dhe ngjala;
- në mars shoja (*passari*), ngjala, *raine* të çdo lloji, trofta⁵⁰;
- në prill zihen kublat e gavonët (ngjala?) me bollëk, kublat e çmueshme e të zgjedhura peshojnë katër a pesë libra secila;
- në maj lica (*lizze*) dhe ama (*ame*) shumë të mëdha;

⁴⁷ (*extra Scutari ad Sanctum Blasium 1433, S. Blasius prope civitatem Scutari 1444*). K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...”, f. 108.

⁴⁸ “*privilegio che no fo ceduto per el Imperator Stephano cum la sua bolla doro per facto de li peschiri*”, O. Schmitt, *Arbëria Venedike 1392-1479...*, f. 135.

⁴⁹ “*D’ Aprile chiepe e Gaoni in abondanza, le chiepe preziose e molto delikate di 4 o 5 lire l’imos, Di maggio Liza et ame grossissim, Di giugno Raine grosse et d’ ogni sorte, Di luglio passere, rimbi, sfogli d’ ogni sorte, Di Agosto cievoli grossi con Buttarghe grosse, Di Settembre mezzani et anguille, Di Ottobre anguille d’ogni sorte, Di Novembre Maurachi, Di Dicembre Gambetti e Varoli, Di Genaro Sarache, Di febraro Scoranze et Anguille, Di Marzo Passare, Rombi, Anguille, Raine d’ogni sorte.*” Francesco Bollizza, *Descrizione di Scutari, Dolcigno et altri luogi : copia trattata dall originale che si conserva nell’Archivio di Stato a Venezia; e da me fatta copiare* [dorëshkrim], 1614, f. 16. Dorëshkrimi në origjinal gjendet në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë.

⁵⁰ “*Relazione di Mariano Bolizza diretta a Michele Maffio, sul sanggiacato di Scutari. Anno 1614*”, në *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII, teksti original dhe përkthimi përgatitur nga Injac Zamputi, vëll. I (1610-1637)*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1963, f. 260, 261.

- në qershor gargaliqa (*raine*)* të mëdhenj të çdo lloji;
- në korrik *pasçere*** , shojza dhe *sfolji**** të çdo lloji;
- në gusht qefuj të mëdhej me putarga të mëdha;
- në shtator qefuj mesatarë dhe ngjala;
- në tetor ngjala të çdo lloji;
- në nëntor *maurachi***** ,
- në dhjetor *corbetti****** dhe *varoli****** etj.

Po ashtu, po sipas Bolicës edhe lumi Buna ishte “shumë i pëlleshëm dhe shumë i pasur me çdo lloj peshkimi dhe çdo stinë” nxirrte peshkun e vet.⁵¹ Pra, siç shihet edhe më sipër, peshkimi ishte i frytshëm, sepse, siç e pamë edhe më lart, çdo stinë dhe çdo muaj kishte peshk të veçantë që mund të zihet në atë kohë. Për zënien e peshkut përdorshin peshkatoret, të cilat ishin të pajisura me anije të madhësive të ndryshme dhe ndodheshin me shumicë, qoftë në liqene, qoftë përgjatë lumit Buna.

Në Shkodër kishte edhe shumë dajlanë që gjendeshin sidomos përgjatë Bunës. Në qytet, aty ku fillon Buna kishte pengesa peshkimi.⁵² Venedikasit donin t’i hiqnin këto pengesa në vitin 1422 me qëllim që anijet të mund të mbërrinin nga deti deri në Shkodër.⁵³ Disa emra dajlanesh, vendndodhjen e të cilëve ne sot nuk mund ta saktësojmë, ishin:

- “Marica”⁵⁴, që i jepte bashkisë të ardhura vjetore 360 hyperperë në vit⁵⁵;
- “dy gjaret”⁵⁶ (*Glaearum*) apo dajlanet e vogla që i jepnin bashkisë të ardhura vjetore 120 hyperperë në vit⁵⁷;

* Mbase këtu bëhet fjalë për peshkun *rajë*, apo *raxhë*. Fjala *raina* nuk gjendet në asnjë fjalor që disponojmë.

** Fjala *pascere* nuk gjendet në asnjë fjalor që disponojmë.

*** Fjala *sfoglio* nuk gjendet në asnjë fjalor që disponojmë, në lidhje me ndonjë lloj peshku.

**** Fjala *maurachio* nuk gjendet në asnjë fjalor që disponojmë.

***** Fjala *corbetti* nuk gjendet në asnjë fjalor që disponojmë.

***** Fjala *varoli* nuk gjendet në asnjë fjalor që disponojmë.

⁵¹ “*Il fiume di Bojana fertilissimo et abbodantissimo d’ogni sorte di pescaggioni, ad ogni staggione produce il suo pesce*”. “Relazione di Mariano Bolizza ...”, në *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë...*, vëll. I (1610-1637), f. 258, 259.

⁵² K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...”, f. 110.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ AAV, XVII, nr. 3196 (bis).

⁵⁵ AAV, IX, f. 165.

- “Gromadura”⁵⁸ (*Gromaduræ*) që i jepte bashkisë të ardhura vjetore 1450 hyperperë në vit⁵⁹;
- “Tajeri i Epër”⁶⁰, për të cilin nuk kemi të dhëna për gjithë vitin;
- “Tajeri i Poshtëm”⁶¹ (*Taier inferus*) që i jepte bashkisë të ardhura vjetore 1450 hyperperë në vit⁶²;
- “Tonja”⁶³ (*Tongarum*) që i jepte bashkisë të ardhura vjetore 40 hyperperë në vit⁶⁴;
- dajlani në Bunë i quajtur “vendi i sipërm” (*el luogo de sora*)⁶⁵, apo (*vivaria superiora*) që i jepte bashkisë të ardhura vjetore 1550 hyperperë në vit⁶⁶.

Nga këto dajlane peshkimi bashkia e Shkodrës, siç e pamë edhe më sipër nxirrte disa të ardhura për të mirën e qytetit.⁶⁷ Në dajlanet e Bunës, në vendin e quajtur “Gjysëm Tajeri i Poshtëm” (*mezzo taiero sotagna*) kishin pjesën e tyre edhe kisha e Shën Shtjefnit dhe kisha e Shën Mërisë.⁶⁸ Gjithashtu në pronë të bashkisë ishin edhe disa peshkore, nga dogana e të cilave bashkia nxirrte shuma të ndryshme.

⁵⁶ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b; Pranvera Bogdani, *Lufta e pricipatës së Balshajve dhe e sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV*. (Disertacion për kërkimin e gradës shkencore “Kandidat i shkencave historike”). Profesor udhëheqës Aleks Buda, Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, 1984, f. 102. (Ndodhet në Arkivin e Institutit të Historisë, A-III-503, nr. inv 3078).

⁵⁷ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b; AAV, IX, f. 164.

⁵⁸ AAV, X, nr. 2486; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b; AAV XVII, nr. 3196 (bis).

⁵⁹ AAV, IX, f. 164.

⁶⁰ AAV, XVII, nr. 3196 (bis); AAV X, nr. 2486; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b

⁶¹ AAV, X, nr. 2486; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b.

⁶² AAV, IX, f. 164.

⁶³ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b.

⁶⁴ AAV, IX, f. 164.

⁶⁵ AAV, XVII, nr. 2999 ter.

⁶⁶ AAV, IX, f. 164.

⁶⁷ P. Bogdani, *Lufta e Principatës së Balshajve ...*, (1984) në *AIH*, A-III-503, f. 102.

⁶⁸ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri ...*, 114/b.

Në atë kohë përdoreshin mesa duket edhe “*kocat*”*, ato përbëheshin nga kurthe gardhiqesh prej kallamash liqeni, që lidheshin me thupra shelgu dhe xunkthi, apo në lumin Buna me materiale të tjera (sot me rrjeta). “Kocat” ndërtoheshin kur kishte kohë thatësire si për shembull në verë, dhe kur shtohet uji në liqen, kocat sillnin edhe peshk. Jemi të mendimit që tek “peshkoret” (*pisceria*)⁶⁹ përfshihen edhe këto “*kocat*”, që me të vërtete përbëjnë një pengesë për anijet dhe për lundrat, qoftë në Bunë, qoftë në liqen. Këto “koca” apo peshkore shiteshin nga pronarët e tyre. Ato ndërtohen dhe përdoren edhe sot akoma nga peshkatarët e liqenit të Shkodrës, pasi ndërtimi i tyre nuk kërkon asgjë tjetër përveçse bimëve të liqenit, kallama dhe thupra shelgu, të cilat janë aty me bollëk. Ekonomia e peshkimit pësoi një goditje të rëndë në Shkodër gjatë vitit 1404, ngaqë Venediku i mori vendet e peshkimit, dajlanët që kishin kishat përgjatë lumit Bunë.⁷⁰

* Kështu quhen sot këto vende peshkimi në gjuhën shqipe nga peshkatarët e liqenit. Autori i këtij artikulli është rritur në afërsi të liqenit të Shkodrës dhe i njeh shumë mirë këto lloj peshkoresh, si dhe mënyrën se si ndërtohen.

⁶⁹ AAlb, II, nr. 748.

⁷⁰ “1404, 20 iunii. Venetiis. Responsiones nuntiis Helenae viduae Georgii Strazimiri dandae: De verbis: “domina, domina respice quid facit, quia nichil potes abscondi sub digito, nam digitus est parvus mons”, quae verba, ut ducunt, ab Antonio Sclavo comestabili Scutariensi, nuntio ser Donati e Porto comitis Scutari in curia praefatae dominae Antibari iniuriose sunt prolata, dominium venetum noticiam non habet. – Mandatibur ser Fantino Marcello in copitem Scutari profecturo examinet beneficia aliquarum ecclesiarum ”penes fluvium Scutari tam a parte nostra quam a parte sua” positarum, “ que quidem ecclesie fuerunt beneficiate antiquitus ab omnibus quondam regibus Sclavonie et etiam ab aliis quondampricibus partium dende preteritis temporibus usque in hodiernum diem, inter que beneficia collata fuerunt certa perizia dicti fluminis”. – Unam pisceriam “in dicto alumine, que antiquitus fuit collata per prefatos dominos, que antiquitus fuit collata per prefatos dominos dictarum partium hominibus servientibus ecclesie s. Petri de Scutaro, in qua ecclesia celebratur ad grisestam”, libere possideat dicta ecclesia. – “Metropolitanus grecus iudex ordinarius habens iurisdictionem super omnem ecclesias et monasteria greca Grecorum Scuteri, creatus per patriarcham Sclavoniae”, habeat omnia iuria, que temporibus praeteritis habeat. – Restituentur stara XXXV frumenti a vasallo quodam praefatae dominae emta et per copitem Scutari arrestata: liceat dictae dominae solutis gabellis solitis frumentum de partibus Scutari extrahere. – Habeat secundum antiquam consuetudinem “ultra salem, qui sibi datur per rektores nostros dictorum locorum pro usu suo videlicet modia centum pro Dulcigno et totidem pro Antivaro”, barchas duas salis, “que sint capaces modiorum CCL pro qualibet”. AAlb II, nr. 748.

Prodhimi i verës dhe pijetoret

Nëse lexojmë dokumentet dhe regjistrin kadastral të Shkodrës, apo edhe burime të tjera, si për shembull veprën e Barletit me titull “*Mbi rrethimin e Shkodrës*”, shfaqen sipërfaqe të tëra të mbjella me vreshta, përreth qytetit, këtu mund të përmendim Kodrën e Pashës kundruall kështjellës, e cila në kohën e Barletit ishte plot vreshta dhe ullishte.⁷¹ Për disa nga këto zona vreshtash të Shkodrës jepen të dhëna në Regjistrin e Kadastrës dhe të koncesioneve të Shkodrës të vitit 1416-1417. Ndër to mund të përmendim vreshtat e Shkodrës:

- Bërdica me vreshtat e saj të shumta, të cilat i përkisnin qytetit të Shkodrës;⁷²
- Bosinovina, Brajakona Radiqavina dhe Sopotit në afërsi të Kalldrunit;⁷³
- Drizitina (Drizetina) Kavlavina, Lazarina Milobratha, Minadina, Oskurusha (Ostorusha), Stanovica, Stretako, Vesekjavina (Vesikjavina) emra vreshtash që ndodheshin diku në afërsi të Podgorës⁷⁴;
- Vreshtat në vendin e quajtur “Ishulli” (*Isola*) diku në Berdicë.⁷⁵ Vreshtat e Shkodrës po në Bërdicë, ku ndodhej edhe një lokalitet i quajtur Sulforada (*sulforada*) sot tashmë i zhdukur dhe i panjohur;⁷⁶
- Vreshta me emrat Jakobashi, Rudi dhe “Vreshti i Rrotullakët”, diku në Grizhë;⁷⁷
- Portat e vreshtave;⁷⁸
- Vreshti pranë vendit Skudi (*Scudo*)⁷⁹.

⁷¹ M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës ...*, f. 37-38.

⁷² *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 17/ b, 18/a, 19/ab, 20/b, 21/a, 23/b, 24/a, 25/a, 28/a, 29/b, 30/ab, 31/ab, 129/a, 134/b, 135/a, 137/b, 144/b.

⁷³ AAV, VIII, nr. 2107/13; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 40/b, 41/a.

⁷⁴ AAV, VIII, nr. 2107/22; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 47/ab, 48/ab.

⁷⁵ AAV, VIII, nr. 2045/89; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 18/a, 135/a.

⁷⁶ AAV, VIII, nr. 2045/153; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 25/b, 30/ab, 31/ab, 134/b.

⁷⁷ AAV, VIII, nr. 2107/58-59; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 60/ab.

⁷⁸ *Regjistri ...*, 19/b, 20/b, 21/a, 159/a.

⁷⁹ AAV, VIII, nr. 2045/88; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 18/a, 135/a

Për vreshtat që përmendëm më sipër, ato që quheshin *Ostorusha*, *Vesikjavina*, *Lazarina* dhe që ndodheshin në Podgorë i përkisnin bashkisë së Shkodrës dhe duhej të punoheshin nga fshatarët e Podgorës, dhe për vitin 1416-17 e gjithë vera që do të prodhohej duhej t'i dorëzohej Sinjorisë venedikase, e cila nga ana e saj ishte e detyruar që të paguante dy ngrënie në vit për të gjithë ata që do të punonin vreshtat e sipërpërmendura të bashkisë.⁸⁰ Kemi të bëjmë këtu me një rast të punës angari që bëhej në Mesjetë, kur punoheshin tokat dhe vreshtat e pushtetarit, në këmbim vetëm të ushqimit.

Në *Statutet e Shkodrës* liria për të mbjellë hardhi është e përcaktuar me nene të veçanta. Aty thuhet që gjithkush që dëshiron të mbjellë hardhi në tokat e veta është i lirë të veprojë.⁸¹ Vreshtat në Mesjetë, mesa duket ishin dy llojesh: 1. vreshtë e gjatë që nënkupton vreshtën e pjergullave që ishin në afërsi të pemëve të mëdha tek të cilat kacavarej hardhija dhe, 2. vreshtë hardhish cung me të cilat mbillej një sipërfaqe e caktuar.⁸² Këto dy forma mbjelljeje dhe kultivimit të hardhive ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në zonën e Shkodrës. Një të dhënë në lidhje me llojin e parë e kemi edhe në regjistrin e kadastrës së Shkodrës të vitit 1416-1417, ku flitet për Nikolla Pamaliozin ushtarak me banim në Shkodër, afër murit të qytetit, të cilit i jepen 19 ara, njëra prej të cilave ishte midis vreshtit, pra supozohet e rrethuar me pjergulla.⁸³ Ndërsa vreshtat e zakonshme me hardhi cung, duhet të jenë ato që i listuam më sipër.

Një rol të rëndësishëm në vreshtari luanin edhe ruajtësit e vreshtave, të cilët kishin detyrë ti ruanin këto nga vjedhjet dhe dëmtimet gjatë periudhës nga fillimi i pjekjes së rrushit deri në vjeljen e tij. Kjo periudhë në *Statutet e Shkodrës* është e vendosur nga dita e festës së Shën Elisë, më 20 korrik deri në ditën e festës së Shën Mhillit që ishte 24 shtatori.⁸⁴ Krahas punës së ruajtjes, roja duhej të bënte edhe punë mirëmbajtjeje në vreshtë si p. sh., të krasisnin, të hapnin rrugët e vreshtës, të lidhnin degët dhe të ngrinin tendat mbështetëse të hardhive siç kishin qenë më parë. Përsa kohë ishte i ngarkuar me ruajtje, rojës duhej t'i besohej në të gjitha

⁸⁰ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 47/b.

⁸¹ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV...*, kreu 31.

⁸² Spiro Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2002, f. 148.

⁸³ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 135/ab shih edhe: S. Shkurti, *Bujqësia në Arbërinë e shek. XIII-XVII ...*, f. 148.

⁸⁴ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV ...*, kreu 82.

që thoshte kundrejt betimit, dhe nëse roja nuk ishte në gjendje ta kapte hajdutin dhe ta dorëzonte, ai ishte detyruar ta paguante vetë dëmin.⁸⁵

Shkodra, nga që ishte vend ku prodhohej verë me shumicë, me sa duket kishte edhe shumë pijetore. Një të dhënë për një pijetore që ekzistonte në kështjellë e kemi nga një dokument i vitit 1400.⁸⁶ Por për këtë pijetore ishte dhënë urdhër që të mbyllej dhe ndërtesa e saj të shembej pasi ishte bërë shkatërrimi i balistarëve të varfër që shërbenin në kështjellë.⁸⁷ Një tjetër pijetore përmendet në kadastrë me emrin “Pijetorja e Shirqit”⁸⁸ (*tauerna San Sergii*), e cila në periudhën e kadastrës i solli bashkisë rreth 320 peprerë⁸⁹.

Ullishtet dhe vaji i ullirit

Në lidhje me kultivimin e ullirit, nëpër burime dokumentare shfaqen sipërfaqe të mbjella me vreshta, përreth qytetit. Megjithëse në Statutet e Shkodrës ullishtet nuk përmenden, nëpër burime të tjera ato janë të pranishme. Këtu, mund të përmendim, Kodrën e Pashës kundruall kështjellës, e cila në kohën e Barletit ishte plot vreshta dhe ullishte.⁹⁰ Duhet të përmendim që ullishte të vjetra gjejmë në fshatin Oblik (4 km larg nga Shkodra) dhe në fshatin Zogaj në breg të liqenit (5 km larg nga Shkodra). Përveç kësaj një vend i pasur me ullishte ishte edhe qyteti i Drishtit (12 km larg nga Shkodra). Shumë prej drurëve të këtyre ullinjve arrijnë moshën mbi 500 vjet.

Pronat e tokave të bashkisë

Bashkia e Shkodrës kishte si pasuri të saj edhe prona tokash, disa ndodheshin p. sh. në zonën e Nënshkodrës, që quheshin “terreni” (toka) dhe shtriheshin nga fshati Glirosi deri në territorin e quajtur Frashën e Buzëgjarpër.⁹¹

Ekonomia e Shkodrës pësoi një goditje të rëndë gjatë viteve 1400-1402 nga sulmet shkatërruese të turqve, për shkak të të cilave u dogj në

⁸⁵ *Po aty*, kreu 82.

⁸⁶ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I. (1400-1405), nr. 12, f. 81.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b.

⁸⁹ AAV, IX, f. 164.

⁹⁰ M. Barleci, *Rrethimi i Shkodrës ...*, f. 37-38.

⁹¹ P. Bogdani, *Lufta e Principatës së Balshajve ...* (1984), në *AIH*, A-III-503, f. 102.

vitin 1400, edhe qyteti.⁹² Ajo u dëmtua edhe më tepër si rrjedhojë e një epidemie që ra mbi popullsinë e saj gjatë periudhës 1401-1402 dhe që solli humbje të mëdha edhe në njerëz.⁹³ “Për të dalë nga kjo situatë bashkësia qytetare e Shkodrës kërkoi nga Venediku një ndihmë prej 2000 dukatësh për të filluar veprimtarinë e vet ekonomike dhe për të vënë në vend dëmtimet e mëdha në fushën e bujqësisë. Sinjoria i dha asaj hua vetëm 1700 dukatë me kusht që ato t’i përdornin vetëm qytetarët që kishin garanci ekonomike për t’i shlyer dhe garanci politike për t’i marrë ato.”⁹⁴ Gjithashtu, Venediku planifikonte ta qetësonte konfliktin me turqit duke u paguar atyre një haraç prej 2000 dukatësh, i cili do të sigurohej duke i vënë bashkësisë qytetare të Shkodrës një taksë të re.⁹⁵ Pra, siç shihet kjo ndihmë do të kishte qenë krejt e kotë, dhe prej saj do të përfitonin vetëm shtresa e pasur e qytetit.

Zejet

Zejet e prodhimit të ushqimit

Ndër profesionet që lidheshin drejtpërdrejtë me furnizimin e banorëve me produkte ushqimore në Shkodër mund të përmenden këto zeje: mullisi⁹⁶, kasapi⁹⁷, furrtari⁹⁸ etj. Përsa i përket mullinjve, ata gjendeshin në qytet aty ku fillon Buna,⁹⁹ ku përgjatë saj thuhej se ka pasur mullinj të shumtë edhe në shekujt e parë pas pushtimit osman, atëherë kur qyteti nuk e kishte marrë akoma veten. Mariano Bolica i përmend këto mullinj edhe në relacionin e tij, ku thotë që “brenda lumit [Bunë] janë ndërtue lloje të ndryshme mullinjsh”¹⁰⁰. Para pushtimit osman, kur qyteti ishte në sundimin e Venedikut, duhet të ketë qenë shumë më i madh se në vitin 1648 – vit në të cilin raporton Bolica, qyteti

⁹² *Po aty*, f. 105.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *Po aty*.

⁹⁵ *Po aty*.

⁹⁶ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV ...*, kreu 28.

⁹⁷ *Po aty*, kreu 29.

⁹⁸ *Po aty*, kreu 65, 109.

⁹⁹ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter...”, f. 110.

¹⁰⁰ “Relazione di Mariano Bolizza ...”, në *Relacione ...*, vëll. I (1610-1637), f. 258, 259.

kishte rreth 400 shtëpi¹⁰¹ – dhe si rrjedhojë duhet të ketë pasur edhe më shumë mullinj. Puna dhe aktiviteti i tyre ka kapitur të veçantë edhe në Statutet e Shkodrës.¹⁰²

Edhe furrat kanë kapitullin e tyre në statutet e qytetit, ku thuhet, se urdhërohet çdo furrtar të mbajë për vete si shpërblim pune jo më shumë se katër bukë për çdo mbushje dhe në rast se vepronin ndryshe ata do të gjobiteshin me 12 groshë.¹⁰³ Në lidhje me pozicionin dhe numrin e këtyre furrave në Shkodrën mesjetare, deri më tani nuk kemi të dhëna. Kasapi ishte një profesion i mirënjohur në atë kohë dhe çdo bagëti që therej në qytet duhej të bëhej tek thertoret e njohura me ligj dhe jo tjetërkund. Nëse dikush therte bagëtitë e veta fshehtas dhe jo tek kasapi në thertore, në qoftë se zbulohet paguante një gjobë prej 12 groshësh.¹⁰⁴

Zejet e veshmbathjeve dhe e cohëve

Zejet e veshmbathjeve në Shkodër ishin të shumta. Këtu mund të përmendim rrobaqepësit, këpucarët, mëndafshpunuesit, leshpunuesit, lëkurëpunuesit, etj. Për një pjesë të këtyre zejeve ka nene të veçanta edhe në Statutet e Shkodrës, kurse të tjerat përmenden nëpër dokumente të ndyshme. Këto zeje kishin një rëndësi të veçantë në ekonominë e Shkodrës, pasi përveç të ardhurave direkte, vinin në lëvizje edhe tregtinë e disa lëndëve të para, siç ishin tregtia e leshit, apo tregtia e lëkurëve, për të cilat folëm më poshtë. Për veshmbathjen mund të përmendim rrobaqepësit,¹⁰⁵ këpucarët¹⁰⁶ dhe mëndafshpunuesit.¹⁰⁷

Zejet e përpunimit të metaleve dhe të veglave

Për përpunimin e metaleve në statute përmenden mjeshtrit e punimit të hekurit¹⁰⁸ që prodhonin ndër të tjera edhe vegla bujqësore. Punimi i

¹⁰¹ “La città col borgo può fare case 400 ...”. Po aty.

¹⁰² Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV ..., kreu 28.

¹⁰³ Po aty, kreu 29.

¹⁰⁴ Po aty, kreu 65.

¹⁰⁵ Aleks Buda, *Shkrime historike*, Tiranë: Toena, 2002, f. 134.

¹⁰⁶ Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV..., kreu 51.

¹⁰⁷ A. Buda, *Shkrime historike ...*, f. 134.

¹⁰⁸ Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV..., kreu 52.

parmendave¹⁰⁹ ishte shumë i rëndësishëm pasi prej këtyre varej kryesisht prodhimi i bujqësisë. Zejtari që merreshin me punimin e parmendave mbroheshin gjithashtu nga shteti dhe kjo mbrojtje ka nenet e saj edhe në statutet e qytetit: “*Nëse provohet me fakte se një person ka vjedhur veglat e një zeytari që prodhon parmenda, fajtori dënohet me katër hyperperë, prej të cilave gjysmën e merr konti dhe gjysmën paditësi. Fajtori paguan edhe dëmin*”¹¹⁰. Mjeshtret e punimit të veglave të tjera bujqësore si zgjedhë qeshë¹¹¹, bela,¹¹² shata¹¹³ dhe hostena¹¹⁴ gëzonin po ashtu mbrojtjen e qeverisë, kur këta villeshin apo grabiteshin. Limuesi gjithashtu ishte një profesion më vete dhe e kishte rrogën 3 groshë sklavonie në ditë.¹¹⁵

Zejet e ndërtimtarisë

Në një qytet të madh si Shkodra padyshim edhe ndërtimtaria kishte zhvillimin e vet dhe për disa nga këto zeje na japin të dhëna statutet e qytetit.¹¹⁶ Këtu mund të përmendim marangozët dhe karpentierët. Marangozët, paga e të cilëve ishte e përcaktuar nga bashkia dhe nuk duhet të ishte më shumë se tre grosh sklavonie në ditë plus një vakt të mjaftueshëm ngrënie.¹¹⁷ Karpentierët e mbulimit të çatave¹¹⁸ e kishin pagën ditore jo më shumë se një grosh dhe një vakt ushqim.¹¹⁹

Zejet e punimeve artistike

Mbi këto zeje, burimet që kemi në dispozicion për Shkodrën heshtin, por ia vlen që të japim këtu një pasazh nga monografia e studiuesit Xhuzepe Gelciq, “*Zeta dhe Dinastia e Balshajve*”, ku jep njoftim për

¹⁰⁹ *Po aty*, kreu 216.

¹¹⁰ *Po aty*, kreu 216.

¹¹¹ *Po aty*, kreu 218.

¹¹² *Po aty*, kreu 52.

¹¹³ *Po aty*, kreu, 52, 217, 218.

¹¹⁴ *Po aty*, kreu 217.

¹¹⁵ *Po aty*, kreu 59.

¹¹⁶ *Po aty*, kreu 32, 39.

¹¹⁷ *Po aty*, kreu 29.

¹¹⁸ *Po aty*, kreu 54.

¹¹⁹ *Po aty*, kreu 49.

këto zeje, duke na paraqitur një tablo të bukur dhe të lulëzuar të tyre, plot zhvillim, prodhim dhe kulturë. Aty ai, kur flet për qytetet arbërore, përmend “punishte që e kishin bërë zakon, të dërgonin në vendet e Ballkanit, në të dyja brigjet e Adriatikut e deri në Maqedoninë e largët punimet fort të hijshme në argjend, në fildish, në koral, në sedef, si dhe lesh e armë të atilla që konkurronin edhe me ato të Damaskut; krahas këtyre prodhonin edhe orendi prej bakri, shumë të stërholluara nga çdo anë.

Qëndisimat me fije ari, me të cilat deri në atë kohë pëlqenin të stoliseshin të mëdhenjtë e vendit dhe gratë më të bukura të Ballkanit, e kishin prejardhjen kurdoherë nga Shqipëria¹²⁰. Pa diskutim, vendi ku duhet të jenë prodhuar këto punime arti duhet të ketë qenë edhe qyteti i Shkodrës. Jo më kot, disa shekuj më vonë Shkodra u bë një ndër qendrat kryesore për punimin e argjendit dhe të filigranit. Në regjistrin e Kadastrës përmenden disa argjendarë apo arëpunues. I pari është argjendari (arëpunuesi) Boksa, i cili banonte pranë mureve të qytetit.¹²¹ Argjendar tjetër që përmendet është edhe Petro Flatari, i cili po ashtu banonte në afërsi të murit të qytetit dhe rrugës së bashkisë.¹²²

Doganat dhe vendkalimet e ndryshme

Në Shkodër vëmë re disa lloje doganash, doganën e kripës, për të cilën folëm edhe më sipër, doganën e peshkimit, doganën e verës, dogana e vajit, doganën e thertoresh, doganën e kullotave, doganën e mëndafshit dhe doganat e importit dhe të eksportit që vilesnin kryesisht në portat e qytetit,¹²³ nga të cilat përmenden dy të tilla porta magjistra dhe Porta del Vinjaro.¹²⁴

Dogana e kripës që mblidhej kryesisht në Shirq i sillte bashkisë së Shkodrës përfitime të mëdha. Ajo ishte aq e madhe sa nganjëherë shërbente për të paguar edhe ushtarët e rroguar që shërbenin jo vetëm në Shkodër por edhe në vise të tjera të Shqipërisë venedike. Një rast i tillë përmendet më 28 shtator 1408, ku Françesk de Musto, i urtë i urdhrave, i

¹²⁰ Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, përktheu nga origjinali Laura Leka, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2009, f. 366.

¹²¹ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 2/a.

¹²² *Po aty ...*, 2/b.

¹²³ O. Schmitt, *Arbëria Venedike ...*, f. 134; shih edhe: AAV IX, f. 164.

¹²⁴ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 19/b, 20/b, 21/a, 159/a.

jep urdhër kontkapedanit të Shkodrës që, nga të hollat që do të nxirreshin nga kripa që i ishte dërguar atij në ditët e shkuara, duhet t'u shkonin në ndihmë rektorëve të viseve të Shqipërisë për pagesat që do t'u bëheshin, qoftë atyre, qoftë ushtarëve të rroguar venedikas që shërbenin në anët e Durrësit dhe në viset e tjera të Shqipërisë, pasi ata nuk ishin paguar dhe ishin ankuar në Venedik.¹²⁵ Sipas një dokumenti të 2 marsit 1409, në vitin 1408 vetëm dogana e kripës në Shkodër kishte arritur shumën e 280 perperëve përfitim për bashkinë.¹²⁶

Dogana e saragave i përkiste bashkisë qytetare të Shkodrës¹²⁷, dhe shitej, si në rastin e vitit 1416-17 që u shit për 80 perperë¹²⁸, dhe aq ishte shuma që i solli bashkisë së Shkodrës atë vit.¹²⁹ Për saragat pranverore që transportoheshin mbahej nga bashkia një në çdo 33 groshë¹³⁰. Kurse doganat e tjera të peshkimit, në mënyrë të veçantë për peshkimin mbi lumin Buna u jepeshin me qira sidomos fisnikëve të Shkodrës apo ndonjë tregtari italian, të cilët krahas pagesës që i bënin bashkisë kishin përfitimet e tyre.

Ndër familjet fisnike që u ishin dhënë me koncesion dogana e peshkut për dajlanet në Bunë mund të përmendim këtu Dukagjinët (Andrea Pal Dukagjini¹³¹ dhe Budimir Dukagjini (*duchainus budimir*), të cilit i ishin dhënë Tajeri dhe dajlani i Gromadurës në vitin 1421¹³², Beganët (Aleks Begani në vitin 1425¹³³), Milotinët (Stefan Milotini nga Shkodra në vitin 1425¹³⁴) kurse ndër tregtarët italianë mund të përmendim Nicolo de Panganin nga Viçenca¹³⁵, Vielmo de Pagnano, i

¹²⁵ *AIH*, A-III-563, *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV...*, vëll.II (1406-1410), dok. nr. 275.

¹²⁶ *Po aty*, dok. nr. 326.

¹²⁷ "ASV. Del. Miste Sen. LIV/ 23rv-23 rv (të dhëna të nxjerra sipas dëshmisë së qytetarëve shkodranë bërë në Venedik më 16 prill 1422)". Pranvera Bogdani, *Balshajt. Lufta e Principatës së Balshajve dhe sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shekullit XV*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2018, f. 91.

¹²⁸ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b.

¹²⁹ *AAV IX*, f. 164.

¹³⁰ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV...*, kreu 274.

¹³¹ "litere scripte comiti scutari pro restitutione fienda Andree pauli duchayno de pescheria sua ...". *AAV III*, nr. 1204.

¹³² *AAV X*, nr. 2486; *AAV XVII*, nr. 3196 (bis)

¹³³ *AAV XVII*, nr. 2999 (bis).

¹³⁴ *AAV XVII*, nr. 2999 (bis).

¹³⁵ Shih edhe: O. Schitt, *Arbëria Venedike ...*, f. 134.

cili në vitin 1421 banonte në Shkodër dhe kishte në përdorim dajlanin në Bunë të quajtur “sipër” (*el luogo de soura*)¹³⁶ dhe Antonio e Paulo de Pagnano de Scutari, të cilët në vitin 1452 jetonin gjithashtu në Shkodër dhe kishin dajlanët e tyre.¹³⁷

Ata që kishin të drejta të peshkonin në ujërat e Shkodrës duhet t'i paguanin taksën kontit të Shkodrës. Në Statutet e Shkodrës janë përcaktuar disa pagesa në lidhje me këto peshkime. P.sh.: kontit duhej t'i jepej një e dhjetta e peshës së ngjalës së peshkuar; një e nënta e krapit dhe një e gjashta për peshqit e tjerë.¹³⁸ Kurse, shuma si taksë në para që duhej të paguhej ishte 1/8 e groshit për peshkun e zënë në liqen.¹³⁹

Dogana e verës së jashtme, apo e verës së mbartur në Shkodër i përkiste gjithashtu bashkisë qytetare të Shkodrës¹⁴⁰, dhe ndahej në dy lloje në doganë e verës së jashtme që hyn në qytet (*vinum Scodram invectum*) dhe doganë e verës së detit që hyn nëpërmjet Bunës (*vinum per Boianam importatum*).¹⁴¹ E para, vera e huaj që hynte në qytet për periudhën 1416-1417 i solli bashkisë së Shkodrës një shumë prej 800 perperësh, kurse vera e huaj rreth 750 perperë¹⁴². Kontrolli i verërave që vinin nga jashtë ishte sigurisht në mbrojtje të prodhuesve vendas, për të cilët prodhimi dhe tregtimi i saj kishte rëndësi jetike për këta fermerë.¹⁴³

Dogana e thertoresh (*la duana de la camarda*) apo siç njihet në regjistrin e kadastrës (*la doana de la becharia*)¹⁴⁴ po ashtu i përkiste bashkisë qytetare të Shkodrës¹⁴⁵. Çdo kasap në mbrëmje duhej të paguante doganën e thertoresh bashkisë së qytetit, pasi ky kishte mbaruar punën. Dogana e thertoresh kishte tarifa të ndryshme sipas llojit të bagëtisë, p.sh: 2 groshë për çdo kokë lope a kau; 1 folar për kokë derri;

¹³⁶ AAV, XVII, nr. 2999 ter.

¹³⁷ AAV, XVII, nr. 5936.

¹³⁸ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV...*, kreu 274.

¹³⁹ *Po aty*, kreu 274.

¹⁴⁰ “ASV. Del. Miste Sen. LIV/ 23rv-23 rv (të dhëna të nxjerra sipas dëshmisë së qytetarëve shkodranë bërë në Venedik më 16 prill 1422)”. P. Bogdani, *Balshajt. Lufta e Principatës së Balshajve ...*, (2018), f. 91.

¹⁴¹ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b.

¹⁴² AAV, IX, f. 164.

¹⁴³ O. Schitt, *Arbëria Venedike ...*, f. 135.

¹⁴⁴ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve ...*, 114/b.

¹⁴⁵ “ASV. Del. Miste Sen. LIV/ 23rv-23 rv (të dhëna të nxjerra sipas dëshmisë së qytetarëve shkodranë bërë në Venedik më 16 prill 1422)”. P. Bogdani, *Balshajt. Lufta e Principatës së Balshajve ...*, (2018), f. 91.

gjysmë groshi për kokë deleje dhe dy groshë për një buall.¹⁴⁶ Nëse kjo pagesë nuk bëhej në mbrëmjen e ditës përkatëse atëherë kasapët ose thertoret paguanin një gjobë prej 12 groshësh. Kjo doganë i sillte bashkisë së Shkodrës rreth 150 perperë.¹⁴⁷

E rëndësishme ishte edhe **dogana e mishit** (*dogana carniun*). Kjo doganë për periudhën 1416-1417 i solli bashkisë së Shkodrës një shumë prej 150 perperë¹⁴⁸. Në lidhje me këtë dhe me mishin që shitej me peshë (*carne a peso*) në Statutet e Shkodrës mungon teksti dhe tek manuskripti origjinal ishte lënë vendi bosh.¹⁴⁹

Dogana të tjera dhe të ardhurat e tyre ishin ajo e vajit që mblidhej në Shën *Shirq* (*dogana olei ad S. Sergium*), e cila për 1416-1417 i solli bashkisë 18 perperë; ajo e drurit të nxjerrë (nga uji i Bunës) (*dogana lignorum extractorum*) me përfitim prej 26 perperë; dogana e Arborazhit në Bunë (*dogana arboraticum in Boiana*) e cila për periudhën e sipërpërmendur solli të ardhura 27 perperë.¹⁵⁰

Përsa u përket vendkalimeve dhe pikave të tyre doganore ato ishin disa. Këtu mund të përmendim *Doganën e Dejës* (*dogana Dagni*) që ishte vendkalim mbi lumin Drin, në rrugën që të çonte për në Serbi, dhe vendkalimet në Bunë, pranë fshatrave Belaj, Shtodër e Drin pranë fshatit Balldren. Kishte edhe një vendkalim tjetër që quhej vendkalimi i qershorit (*pasus iunii*), i cili i solli bashkisë 115 perperë në periudhën e Kadastrës.¹⁵¹ *Dogana e Dejës* i sillte bashkisë së Shkodrës me mijëra perperë. Për periudhën 1416-1417 shuma e nxjerrë prej saj ishte 2200, kurse vendkalimet e Belajt (*bellani*), Shtodrit (*San theodoro*) dhe Balldrenit vetëm 24 perperë të gjitha së bashku.¹⁵²

Në nëntor të vitit 1409 doganat u vunë nën kontrollin e një dhomëtari venedikas, i cili qe nisur për në Shkodër apostafat për këtë qëllim dhe qe vendosur “që në asnjë mënyrë apo marifet, në *Shkodër* apo jashtë të mos mund të bëhej ndonjë doganë, koncesion apo ankand i ndonjë dogane, takse apo të ndonjë çfarëdo gjëje të bashkisë së qytetit, pa pëlqimin e të

¹⁴⁶ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV...*, kreu 65.

¹⁴⁷ AAV, VIII, nr. 2158/90

¹⁴⁸ AAV, IX, f. 164.

¹⁴⁹ *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV...*, kreu 66. (*resta lo spazio bianco per 11 righe per il testo del capitolo non trascritto.*)

¹⁵⁰ AAV, VIII, nr. 2158/90; *Regjistri ...*, 114/b; AAV IX, f. 164.

¹⁵¹ AAV, VIII, nr. 2158/90; AAV IX, f. 164.

¹⁵² AAV, VIII, nr. 2158/90; AAV IX, f. 164.

sipërthënëve dhomëtarëve tanë të *Shkodrës*¹⁵³. Ky dhomëtar, duhej të kujdesej për të hetuar dhe për të nxjerrë siç duhet të ardhurat dhe pasuritë e bashkisë së Shkodrës brenda dhe jashtë qytetit dhe për ta përmbushur këtë detyrë ai duhej të qëndronte gjatë gjithë kohës në zyrën tij, kishte në dispozicion dy kuaj, rrogën vjetore dhe njëzet e pesë dukatë ar për shpenzimet e kuajve.¹⁵⁴

* * *

Këto, pra ishin disa të dhëna në lidhje me ekonominë e Shkodrës në Mesjetë, sidomos në periudhën e shek. XV, të cilat synojnë të paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të disa degëve më të rëndësishme të ekonomisë së këtij qyteti.

S u m m a r y

SOME ASPECTS OF MEDIEVAL SCUTARI'S ECONOMY

Through this article is intended to provide some information about the economy of Shkodra in the Middle Ages, especially in the period of the 15th century. The article presents a general overview of some important branches of the economy in this city. There is much information on money, different types of coins used in the city over the years; data on production and trade and most important crafts and laws governing these crafts, according to medieval statutes of Shkodra.

¹⁵³ *AIH*, A-III-563, *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV ...*, vëll. II (1406-1410), dok. nr. 423.

¹⁵⁴ *Po aty*.

